



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.69, datë 20/12/2005

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME TË CILAT JANË NË TERRITORIN NËN
JURIDIKSIONIN E BASHKISË SË TIRANËS ”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.8743, dt.22/02/2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit Nr.8744, dt.22/02/2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.500, dt.14/08/2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” pika 12 dhe 13, Udhëzimit Nr.3, dt.18/07/2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimit Nr.15, dt.30/06/2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, pika 1/a dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Miratimin e Listës së Pjesshme të Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës.

Lista e inventarit fillon me numrin 1 (një) dhe mbaron me numrin 3341 (tremijëetreqindedyzetënjë) me numër fletësh 581 (pesëqind e tetëdhjetë e një) .

2. Paraqitjen e Listës së Inventarit për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Aseteve. (Sektori i Inventarizimit të Pronave të Paluajtshme).
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI